

Informatat mbi grantin

Instrumenti:	Grant Institucional
Organizata Implementuese (përfshirë partnerin nëse është e aplikueshme):	Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)
Kontaktet e organizatës: Adresa, email, telefonat, web faqja	Rr. Fehmi Lladrovci Nr. 94, 20000-Prizren & Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000-Prishtinë info@ecmandryshe.org +381 38 29 222 771 & +381 224 967 www.ecmandryshe.org
Kohëzgjatja: 36 muaj	Data e fillimit: 01/01/2021 Data e përfundimit: 31/12/2023
Buxheti i përkrahur nga programi:	114,900.00 EUR
Buxheti total:	867,058.00 EUR
Shtrirja gjeografike:	Kosovë
Grupet e synuara:	Grupet kryesore të synuara të programit (dhe të organizatës në përgjithësi) janë grupet e nënpërfaqësuar të komunitetit: të rinjtë, gratë dhe vajzat, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar dhe banorët e lagjeve joformale.
Përmbledhje e intervenimit:	<p>EC edhe më tej do të mbetet organizatë me bazë në komunitet. Temat dhe çështjet mund të ndryshojnë, por çfarë mbetet konstante është metodologjia. EC beson në nevojën dhe domosdoshmërinë e organizimit komunitar si garancën më të madhe të demokratizimit dhe zhvillimit. Demokracia dhe zhvillimi qëndrojnë në marrëdhënie varësie, ndërsa kjo e fundit domosdoshmërisht duhet të zbatohet në korniza qëndrueshmërie. Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në periudhën 2020 – 2024 ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen.</p> <p>Aktiviteti i organizatës do të synoj përmbushjen e tri objektivave strategjike:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. Komunitete lokale të mirorganizuar dhe presioni i rritur publik nxisin praktika të përparuar të qeverisjes demokratike dhe gjithëpërfshirëse në komunat e Kosovës ii. Dimensionet mjedisore dhe sociale të integruara në programe dhe politika që synojnë zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm lokal dhe rajonal iii. Vëllim i rritur i dijes sektoriale për të ushqyer debatin shoqëror dhe politikëbërjen, si dhe një organizatë me shtathtësi të konsoliduara programore dhe qëndrueshmëri institucionale.

Bashkëfinancuar nga: